

PROCESVERBAL
nga seanca e 23-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 19.6.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, mr. Gordana Majnova, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Petreska-Kamenjarova, mr. Lucija Gjirkoviq-Dodevska, mr. Ivona Mufisheva, Maja Damevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 23-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 7 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 22-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 10.6.2026.

2. Propozim-vendim për përcaktimin e listës së eventeve me rëndësi të madhe për publikun e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj ShTR Televizioni Plus ShPK Kumanovë për shkelje të nenit 15, paragrafi (6) i Ligjit për Media.

4. Propozim për shqiptimin e masës paralajmërim publik të operatorit Fivenet ShPK Shkup, për shkelje të nenit 141 i LSHMAAV-së.

5. Informacion në lidhje me deklarimin me shkrim nga mbikëqyrja administrative e botuesit të medias online – internet portalit "Nova Makedonija".

6. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe, me 5 vota "pro" dhe dy abstenime nga Petar Xhurovski dhe Gordana Majnova, miratoi Procesverbalin e seancës së 22-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 10.6.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, informoi se debati publik mbi Draft-vendimin përfundoi më 12 qershor 2026. Ai theksoi se propozim shtesë ishte paraqitur menjëherë para seancës, për të cilin shërbimi profesional nuk kishte kohë të mjaftueshme për të kryer analizë dhe për të dhënë mendim profesional, i cili në pajtim me detyrimet ligjore është i nevojshëm për secilin propozim të paraqitur. Edhe pse propozimi ishte paraqitur pas skadimit të afatit për debat publik, ai propozoi që të shqyrtohet nga shërbimi profesional, pas së cilës pika të shtyhet për vazhdimin e parë të seancës së 23-të.

Zëvendësja e kryetarit mr. Zirjeta Jajaga, u pajtua se është e nevojshme që shërbimi profesional të kryejë analizë të propozimit të paraqitur. Gjithashtu theksoi se gjatë shqyrtimit të tij, duhet të merren parasysh ndryshimet në kuadrin ligjor nga viti 2018, të cilat janë relevante për procedurën e miratimit të Vendimit.

Këshilltarja mr. Gordana Majnova pyeti nëse propozimi i paraqitur iu dërgua vetëm drejtorit dhe shërbimit profesional apo edhe anëtarëve të Këshillit, në mënyrë që ata të informoheshin në kohë për përmbajtjen e tij.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, sqaroi se propozimi është paraqitur menjëherë para seancës, pas së cilës ia ka dërguar drejtorit të Agjencisë.

Këshilltarja Afrona Vërzivolli theksoi se në propozim si pranues ishin cituar vetëm kryetari dhe anëtarët e Këshillit të Agjencisë, dhe gjithashtu ishte cituar themeli ligjor mbi të cilin bazohet propozimi. Ajo theksoi se nëse duhet kohë shtesë për analizë nga shërbimi profesional, kjo është e pranueshme, dhe gjithashtu njoftoi se propozimi do t'u përcillet dhe anëtarëve të tjerë të Këshillit.

Këshilltari Petar Xhurovski vlerësoi se do të ishte korrekte që propozimi, përveç kryetarit, t'u paraqitet edhe të gjithë anëtarëve të Këshillit.

Kryetari Stefanovski propozoi që shqyrtimi i pikës të shtyhet deri në vazhdimin e seancës.

Këshilli njëzëri e pranoi propozimin dhe vendosi që shqyrtimi i pikës të shtyhet deri në vazhdimin e parë të seancës së 23-të.

Pika 3

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi se transmetuesi ShTR Televizioni Plus ShPK Kumanovë në periudhën e kaluar është përballur me probleme të caktuara në punë, të cilat u konfirmuan nga shkeljet e konstatuara më parë. Ai kujtoi se në seancën e mëparshme të Këshillit, transmetuesit iu shqiptua masë paralajmërim publik për mosdorëzim të të dhënave, të cilat në përputhje me detyrimet ligjor, duhej të dorëzoheshin deri më 31 mars 2026.

Në këtë rast konkret, transmetuesi nuk e ka paraqitur Raportin mbi zbatimin e konceptit programor, që paraqet shkelje të nenit 15, paragrafi (6) të Ligjit për Media. Prandaj, propozohet shqiptimi i masës paralajmërim publik, të caktohet afat prej 45 ditësh për harmonizim dhe të kryhet mbikëqyrje kontrolli pas skadimit të afatit.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt administrative nr. 03-2196/1 të datës 20.5.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive Televizioni Plus ShPK Kumanovë t'i shqiptohet masë paralajmërim publik për për shkelje të nenit 15, paragrafi (6) i Ligjit për Media, përkatësisht, në afatin e parashikuar ligjor (31 mars 2026), nuk i ka dorëzuar Agjencisë raport me shkrim mbi zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në lejen për transmetim televiziv, veçanërisht për zbatimin e konceptit programor, as informacion mbi mjetet teknike përmes të cilave transmetohet ose ritransmetohet shërbimi programor në vend ose jashtë vendit.

Në përputhje me pikën 7 të Udhëzimeve për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (tekst i pastruar) nr.01-4241/1 datë 1.10.2025, urdhërohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Televizioni Plus ShPK Kumanovë, në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit për paralajmërim publik, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e Ligjit për Media.

Spektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj transmetuesit të lartpërmendur.

Spektori për çështje programore, pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për paralajmërim publik, të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar në përputhje me masën e shqiptuar.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 4

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajçevski, shpjegoi se gjatë mbikëqyrjes së kryer është përcaktuar se operatori Fivenet ShPK Shkup ritransmeton shërbimin programor "Al Jazeera", i cili nuk mbulohet nga çertifikata e lëshuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Prandaj, propozohet t'i shqiptohet masë paralajmërim publik, operatori menjëherë të ndalojë me ritransmetim të shërbimit programor dhe të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse është vepruar sipas vendimit të Këshillit.

Këshilltari Petar Xhurovski pyeti nëse kemi të bëjmë me shërbim programimi lidhur me transmetimet e Kupës së Botës.

Drejtori Trajçevski sqaroi se nuk bëhet fjalë për shërbim programesh sportive por për shërbim programor "Al Jazeera".

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të rregullt programore nr.11-2458/1 të datës 12.6.2026 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë së Shërbimeve të Telekomunikacionit Fivenet ShPK Shkup t'i shqiptohet masë paralajmërimi publik për shkelje të nenit 141, paragrafi (13) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, sepse sipas notifikacionit(njoftimit) nga Agjencia për Komunikime Elektronike, mund të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë, më 9.6.2026, për përdoruesit e saj ritransmetoi shërbimin programor "Al Jazeera", që nuk mbulohet nga çertifikata për regjistrim të shërbimeve programore të lëshuar nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Në përputhje me pikën 8 të Udhëzimeve për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (teksti i pastruar) nr.01-4241/1 datë 1.10.2025, urdhërohet menjëherë pas pranimi të Aktvendimit për paralajmërim publik të

harmonizojë veprimtarinë e saj me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendim për paralajmërim publik për Shoqërinë e Shërbimeve të Telekomunikacionit Fivenet ShPK Shkup.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejta e autorit të kryejë mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes ka vepruar në përputhje me masën e shqiptuar.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 5

Ndihmës-udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të të drejtat e autorit, mr. Lucija Gjuroviq- Dodevska, informoi se më 30 prill 2026, është kryer mbikëqyrje e rregullt administrative mbi Shoqërinë për prodhim, qarkullim dhe shërbime Repro print ShPKNJ P eksport-import Shkup, botues i portalit të internetit "Nova Makedonija". Gjatë mbikëqyrjes, u konstatua se detyrimi sipas nenit 15, paragrafi (5) i Ligjit për Media nuk ishte përmbushur plotësisht për shkak se dokumenti i regjistrimit të themeluesit të huaj nuk ishte dorëzuar në origjinal dhe ishte më i vjetër se afati i përcaktuar ligjor. Pas dorëzimit të Raportit dhe Kërkesës për deklaratë, botuesi në afatin ligjor dorëzoi shpjegim dhe dokumentacion të ri, të vlefshëm për personin juridik të huaj - themelues, me çertifikim dhe përkthim të përshtatshëm. Në deklaratë u përmendën arsyet objektive pse dokumentet nuk mund të siguroheshin në periudhë më të shkurtër. Duke marrë parasysh se ndërkohë është dorëzuar dokumentacion i plotë dhe i vlefshëm, u propozua që Këshilli të konkludoi se nuk ka baza të mjaftueshme për shqiptimin e masës paralajmërim publik dhe të njoftohet botuesi i medias.

Këshilltari Petar Xhurovski pyeti nëse rasti lidhej me ndryshim të strukturës pronësore.

Mr. Lucija Gjuroviq- Dodevska sqaroi se nuk bëhet fjalë për asnjë ndryshim, por për paraqitjen e dokumentacionit për personin juridik të huaj – si themelues, të regjistruar në lshujt e Virgjër Britanikë, që kërkonte kohë shtesë.

Zëvendësja e kryetarit mr. Zirjeta Jajaga, konstatoi se bëhet fjalë për çështje teknike lidhur me sigurimin dhe përkthimin e dokumenteve.

Mr. Lucija Gjuroviq-Dodevska konfirmoi se nuk ka ndryshime në strukturën pronësore dhe se shkak u lidhet veçanërisht me afatet për sigurimin dhe përkthimin e dokumenteve.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Informacionin në lidhje me Deklaratën mbi Raportin me shkrim të mbikëqyrjes administrative nga botuesi i medias online – internet portalit "Nova Makedonija" dhe njëzëri konkludoi se në rastin konkret nuk ka bazë të mjaftueshme për shqiptimin e masës paralajmërim publik ndaj Shoqërisë për prodhim, qarkullim dhe shërbime Repro Print ShPKNJ P eksport-import Shkup.

Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit të njoftoj Shoqërinë për prodhim, qarkullim dhe shërbime Repro Print ShPKNJ P eksport-import Shkup për këtë përfundim.

Sektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit ta publikojë Përfundimin në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 6 - Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani